



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Dragash  
Opština Dragas  
Municipality of Dragas

Drejtorati për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit  
Direktorijati za urbanizam, katastar i zaštitu sredine  
Directorate for urbanism, cadastre and environment protection

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Dragashit dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Dragashit, dhe ligjeve në fuqi që veprojnë brenda Drejtoratit përkatës, paragesin planin e mëposhtëm të punës të Drejtorisë në fjalë për vitin e ardhshëm 2023.

Plani vjetor i punës së Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit mbulon periudhën nga 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Koncepti i këtij plani duhet të kuptohet vetëm si një kornizë me një afësi mjafit fleksibile dhe dinamike për t'u përshtatur me ndryshimet dhe përaftrimin në kohë të planit me zhvillimet aktuale dhe zhvillimin e komunës së Dragashit.

Si qëllime më të rëndësishme të këtij plani janë:

I. Përmirësimi i efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtorisë që nënkupton:

1. Punësimi i 2 zyrtarëve në ZKK Dragash:

- një jurist i diplomuar,
  - një në zyrën e pranimit të gjeodezisë,
2. Organizimi funksional i punës të ZKK-së Dragash, që nënkupton:
- pranon kërkesat në sportel (nga ana e palëve, gjeodetëve privat, avokatëve, noterëve etj).

**II. Kontakte dhe bashkëpunime të vazhdueshme dhe cilësore me Drejtoritë, palët, ministritë, organizatat ndërkombëtare.**

**III. Sigurimi i disiplinës së punës në një nivel që siguron kushtet për funksionimin e duhur të Drejtorisë.**

**IV. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Inspeksionit - Inspektori i Ndërtimit, për të rritur kërkesat për marrjen e lejeve të ndërtimit të gjitha në bazë të Ligjit për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ.**

**V. Qëllimet e tjera**

Në kryerjen e punëve dhe detyrave të saj, Drejtoria do të drejtojë veprimtarinë e saj drejt realizimit të detyrave që nuk kanë përfunduar në vitin e kaluar 2022, që është zhvillimi i planeve zhvillimore dhe urbanistrike për territorin e komunës sonë dhe hartat zonale të Komunës, që paraqet detyrim ligjor të komunës sonë.

Prioritete të rëndësishme këtë vit janë:

- legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas ligjit që merret me këtë gëshje, i cili u miratua në Kuvendin e R.Kosovës;
- përfundimi i dixhitalizimit të kadastrës së pasurive të patundshme dhe rrjetit kadastral;
- realizim efikas dhe në kohë i projekteve të infrastrukturës në kuadër të investimeve kapitale, buxhetit fiskal për vitin 2020 dhe donacioneve nga burime të ndryshme;
- hartimi dhe miratimi i rregullave për funksionimin efikas të Drejtorisë, bërë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Punët e rregullta:

- Procedura administrative dhe puna me klientët
- Aktivitetet për mbrojtje mjedisore;
- Iëshimi i lejeve të ndërtimit dhe kushteve teknike për ndërtim;
- ofrimin e ndihmës teknike për drejtoritë e tjera;
- pjesëmarrja në Bordin e Drejtorëve;
- përgatitja e raporteve dhe planeve të punës;
- dhe detyra të tjera të rregullta bazuar në ligjin në fuqi.

Me respekt!  
Drejtori: Bean Hadziasan